



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 12/11

Prishtinë, më 11.05.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Duda Balje, Latif Gashi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Hasime Krasniqi, Muhamet Mustafa.

Munguan: Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rrahman Paçarizi dhe Sylejman Shaqiri nga RTK, Dino Asanaj dhe Shkëlzen Lluka-AKP, Lage Olofsson-ZAP, Skott Bowen nga AKP dhe Miran Zeneli nga KPSHCRK.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i ProjekSIONIT të të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën 1 janar -31 dhjetor 2011. I ftuar: Rrahman Paçarizi, Kryetar i Bordit të RTK-së;**
- 3. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2010. I ftuar: Dino Asanaj, Kryetari i AKP -së;**
- 4. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010. I ftuar: Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm;**
- 5. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2010, I ftuar: Scott Bowen, Drejtor Ekzekutiv i AKP-së;**
- 6. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2010. I ftuar: Mehdi Geci, Kryetar i KPMSHCK;**
- 7. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2010, I ftuar: Osman Ejupi, Kryetar i Autoritetit të Konkurrencës në Kosovë;**

8. Shqyrtimi i propozimit të Komisionit për Përzgjedhjen e anëtarit dhe Kryesuesit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi që pika e tretë e rendit të ditës të kalojë në pikën e dytë.

Rendi ditës miratohet rirenditje e pikave të rendit të ditës

2. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2010

Kryetarja, tregoi që buxheti i kësaj agjencie është shpenzuar rreth 89%, raporti është i detalizuar si dhe është paraqitur pjesa që ka të bëjë me gjendjen e llogarive sipas kategorive.

Dino Asanaj, prezantoi shkurtimisht pjesën financiare të raportit vjetor për vitin 2010, duke theksuar që AKP-ja ka vazhduar me valë të reja të likuidimit dhe me metodën e rregullt të *spin-off*-it.

Sali Asllanaj, shprehu qëndrim negativ ndaj AKP-së, pasi që procesi i privatizimit i ka shkaktuar dëme të mëdha Kosovës, sepse mbikëqyrja e zbatimit të privatizimit, sidomos e ndërmarrjeve me *spin off* special, nuk ka qenë në nivel dhe për këtë ka nevojë për përmirësime dhe për seriozitetin e njerëzve që janë të angazhuar në AKP. Theksoi se nuk mbështet raportin.

Latif Gashi, vlerësoi raportin si të detalizuar dhe të përgatitur mirë. Nga raporti shihet që AKP-ja nuk ka qasje në Minierën e Trepçës në pjesën veriore të Mitrovicës, lidhur me këtë se qfarë është qëndrueshmëria e financimit të kësaj ndërmarrje dhe çfarë masash janë ndërmarrë nga kryetari i bordit të AKP-së në këtë drejtim, a iu është bërë kërkesë zyrtare ICO, për të diskutuar për këto probleme apo a është ndonjë masë tjetër konform ligjit?

Hasime Krasniqi, kërkoi sqarime lidhur me subvencionet dhe transferet si dhe për numrin e të punësuarve në agjenci. Për mjetet nga donatorët, pyeti se ku ka mbetur pjesa e pa shfrytëzuar për paga dhe se shuma më e madhe e mjeteve të privatizimi është mbi 3 milion €?

Muhamet Mustafa, vërejtje më e madhe për procesin e privatizimit, është mbetja e mjeteve nga fondi i privatizimit, jashtë funksionit ekonomik, që po ndikon negativisht në proceset ekonomike të Kosovës dhe në përgjithësi në zhvillimin ekonomik. Lidhur me këtë, mendimi i tij ishte që duhet të tregohet ekspertizë dhe konsensus në shoqëri, në mënyrë që këto mjete të mos mbeten të ngrira dhe jashtë funksionit ekonomik. Kërkoi informata më të hollësishme për këtë çështje duke kërkuar mënyrat adekuate që ata mendojnë t'i përdorin për zgjidhjen e këtij problemi? Pyetja tjetër ishte se çka punon agjencia dhe çfarë janë raportet e AKP-së me institucionet tjera për zgjidhjen e këtij problemi?

Dino Asanaj, lidhur me *spin-off*-in special të cilin e ka përdorur ish AKM-ja, theksoi që kjo ka qenë një metodë e privatizimit shumë e gabuar dhe e dështuar. Sa i përket minierës së Trepçës u përgjigj se AKP-ja nuk ka qasje në atë pjesë, edhe pse u ndahen mjetet, por ata nuk raportojnë dhe për këtë ka pasur vërejtje edhe në raportin e auditimit. Lidhur me çështjen e Trepçës, janë mbajtur disa tryeza të rrumbullakëta me ICO-në, mirëpo edhe ata hezitojnë, sepse as ata nuk kanë qasje në atë pjesë. Fondet e Komisionit Evropian nuk janë shfrytëzuar në tërësi, pasi që i lirohen agjencioit për pagesën e pagave më këste. Numri i punëtorëve në agjencion është 248 nga stafi vendor, por ka edhe asistencë teknike nga KE si dhe një numër i përfaqësuesve të ICO-së. Sa i përket 20%-shit të punëtorëve, AKP-ja ka

ndërmarrë një iniciativë për shpërndarjen e përkohshme të 20%-shit, që do të jetë më e shpejtë dhe më mirë edhe për ekonominë e Kosovës. Për fondet e privatizimit, tregoi që AKP-ja në fund të vitit 2009, ia ka dërguar një kërkesë BQK-së për kthimin e mjeteve të fondit të privatizimit në Kosovë, për të cilën kërkesë ende nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Mirëpo, në bazë të ligjit, për ato mjete nuk ka mundësi investimi në Kosovë, në mungesë të Ligjit të Letrave me Vlerë. Sipas ligjit, mjetet e mbetura pas likuidimit të ndërmarrjeve i kalojnë buxhetit të Kosovës dhe pas përfundimit të procesit të procesi i likuidimit për një ndërmarrje merr dyzet e dy muaj.

Kryetarja, konstatoi se me tetë vota Për (Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Duda Balje, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami dhe Muhamet Mustafa) një Kundër (Sali Asllanaj) dhe asnjë Abstenim, komisioni nxori këtë:

R E K O M A N D I M

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2010.

3. Shqyrtimi i ProjekSIONIT të të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2011

Kryetarja theksoi se plani i prezantuar më tepër është sintetik dhe në mënyrë të përgjysmuar. Kemi marrë një listë të pagave nga e cila është vështirë të përcaktohet se sa është numri i punëtorëve në RTK. Në vazhdim kërkoi të sqarohen pagat e punëtorëve me paga të rregullta dhe kontrata tjera? Si qëndron çështja e fondit me pagat e bordit të RTK-së ?

Rrahman Paçarizi, konform kërkesës së Komisionit për Buxhet dhe Financa, kanë përgatitur projektin e të hyrave dhe shpenzimeve vjetore për vitin 2011. Shihet se buxheti është dukshëm më i varfër se në vitet e tjera. Është një projektion që të cilit shpresoj ti përmbahemi dhe duhet të heqim dorë nga një pjesë nga programet nga produktet.

Kryetarja, kërkoi detalizim për çështjen e pagave, për shkak se nga raporti i vitit të kaluar më tepër se gjysma e buxhetit ka shkuar për paga dhe mëditje. Kuvendi duhet ta ketë një plan për mënyrën e shpenzimit të mjeteve nga RTK-ja.

Latif Gashi, propozoi që Projektionit të të hyrave dhe shpenzimeve të RTK-së t'i bashkangjitet një material shtesë në lidhje me vërejtjet që u theksuan nga kryetarja, në mënyrë që të njoftohet Kuvendi.

Duda Balje, pyeti sa kushton një minutë reklamë në RTK?

Hasime Krasniqi, theksoi që RTK-ja ka arritur ta ruajë sado pak pavarësinë editoriale me përkrahjen e Kuvendit të Kosovës, por shprehu besimin që pas kompletimit të Bordit dhe zgjedhjes së Kryetarit të Bordit do të arrijë që në të vërtetë ta ruajë pavarësinë editoriale dhe pas miratimit të Ligjit për RTK-në do të arrijnë të sigurojnë të hyra vetanake. Sa i përket pagave, theksoi që ekziston një laramani e pagave, duke kërkuar sqarime se në bazë të cilave kritere janë caktuar këto paga?

Sali Asllanaj, pyeti se çfarë planifikime ka RTK-ja për kategorinë e investimeve kapitale që janë paraqitur në projektion në vlerë prej 1.200.000 €, si dhe shprehu shqetësimin për pagat e të punësuarve.

Hykmete Bajrami, komentoi lidhur me pjesën financiare të raportit, për shqyrtimin e të cilit ka anomali, për shkak të mungesës së raportit të auditorit. Lidhur me pavarësinë editoriale theksoi që RTK-ja nuk e ka pasur këtë pavarësi gjatë gjithë asaj kohe sa është financuar nga Qeveria.

Latif Gashi, nuk u pajtua me mendimin e parafolësës, duke theksuar që RTK-ja ka dhënë edhe informacione të këqija për Qeverinë.

Jelena Bontic, pyeti se sa përqind e territorit të Kosovës mbulohet nga sinjalet e RTK-së, pasi që në komunën e Shtërpçës prej nga vjen ajo, nuk ka sinjal të RTK-s? Pyetja tjetër ishte për numrin e të punësuarve, pse kaq i madh, përderisa pati kritika lidhur me programet e RTK-së?

Kryetarja, pyeti se a ka ndryshime në çështjen e pagave të Bordit në krahasim me atë se çka është planifikuar në vitin e kaluar?

Rrahman Paçarizi, financimi qëndrueshëm do të krijonte hapësirë për funksionim më të mirë në tregun e marketingut me ç'rast do të përfitonin edhe transmetuesit komercialë. Vërejtja e Auditorit të Përgjithshëm në draftin e raportit ka qenë në vonesën e pagesave ndaj partnerëve të jashtëm. U përgjigj se nuk ka ndryshime nga ajo se çka është planifikuar, edhe pse ka pasur raporte nëpër media për rritjen e pagave të Bordit. Në raportet e shpenzimeve të vitit 2009 dhe 2010, ka njoftime reale për rritjen e shpenzimeve të Bordit, duke e pasur parasysh që në vitin 2009 kanë qenë vetëm katër anëtarë vendorë të Bordit të cilët janë paguar nga RTK-ja, ndërsa tre anëtarëve tjerë u janë paguar mëditjet për rrugë pasi që ta kanë qenë të jashtëm. Pagat e Bordit janë rritur para një viti, ndërsa tani mëditjet janë të caktuara në baza mujore, pavarësisht numrit të mbledhjeve se sa mbahen.

Sylejman Shaqiri, sqaroi se investimet kapitale kanë të bëjnë me produktet televizive të cilat RTK-ja i trajton si mjete themelore. Hapësira reklamuese paguhet me sekonda, për të cilën ekziston çmimorja e miratuar nga Bordi i RTK-së. Çmimi mesatar është rreth 4 € për sekonda. Sa i përket mbulueshmërinë së territorit të Kosovës nga RTK-ja, situata nuk është e mirë pasi që sipas barometrave teknike mbi 50 % e territorit mbulohet, kurse realisht është rreth 70 % mbulueshmëria. Për numrin e të punësuarve janë zvogëluar kontrata mbi veprën.

Kryetarja, konstatoi se komisioni një zëri nxori këtë:

REKOMANDIM

1. Komisioni përkrahur projeksionin e të hyrave dhe shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës, për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2011, në shumën prej 9.500.000 Euro.
2. I rekomandohet Administratës së Kuvendit, të transferojë mjetet buxhetore nga buxheti i Kuvendit – kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në xhirollogarinë e RTK-së nr. 11101101219060187, për periudhën 1 prill – 30 qershor, në shumën prej 1,311.333 Euro.

4. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010

Lage Olofsson, tregoi që në bazë të raporteve financiare po shihet që kjo organizatë po rritet shumë shpejt e cila po ndikon edhe në strukturën e shpenzimeve. Gjatë këtij viti kemi bërë një menaxhim financiar të detalizuar, duke u munduar që ta shpenzojmë buxhetin në mënyrën më të mirë të mundshme. Në përgjithësi për mallrat dhe shërbimet kemi zvogëlime. Jemi të vendosur në një objekt privat, nga pamundësia e Qeverisë që ta bëjë një zgjidhje më të përshtatshme. Sa i përket detyrimeve, ato janë shumë të vogla dhe nuk ka probleme në këtë drejtim.

Latif Gashi, lidhur takimin që ka pasur Auditori me Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, ku është premtuar se do të kalojnë në objektin e administratës tatimore, por kjo gjë nuk ka ndodhur. Pyeti që nga ajo kohë a i keni paraqitur Qeverisë ndonjë kërkesë tjetër, apo a keni pasur ndonjë takim tjetër për këtë çështje?

Sali Asllanaj, pyeti se a ka përpjekje për ndihmë të autoriteteve politike në punën e ZAP-së, dhe ku janë defektet më të mëdha në shpenzimet buxhetore?

Duda Balje, pyeti se sa është numri i të punësuarve në ZAP?

Lage Olofsson, pohoi pasi që Qeveria nuk ka qenë në gjendje ta bëjë një zgjidhje për objekt, e kanë ndërruar objektin me qira që ofron kushte më të mira dhe është më i lirë, ndërkaq për këtë çështje më nuk ka pasur më diskutim. Sa i përket numrit të të punësuarve, sqaroi se janë 116. Si defekt në shpenzimet buxhetore mund të përmendet pavarësia financiare e cila nuk është në nivel.

Latif Gashi, pyeti lidhur me atë se a ka pasur raste kur nuk janë përputhur raportet e auditorit të jashtëm me raportet e auditorëve të brendshëm të institucioneve të caktuara buxhetore?

Hasime Krasniqi, lidhur me synimin që është paraqitur në raport për ndërtimin të ndërtohet një Zyre kombëtare e auditimit në Kosovë të udhëhequr nga kosovarët, pyeti kur pritet të ndodh kjo?

Lage Olofsson, sqaroi se pas përfundimit të strategjisë pesë vjeçare të zhvillimit të përbashkët, ZAP do të jetë një institucion suprem i auditimit që do të kryejë aktivitetin në mënyrë të qëndrueshme në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe në pronësi të plotë të kosovarëve. Sa i përket auditimit të brendshëm theksoi që ka shumë dallime midis qasjes në krahasim me qasjen që e kanë auditorët e brendshëm.

Kryetarja, konstatoi se komisioni një zëri nxori këtë:

REKOMANDIM

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2010.

5. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2010

Kryetarja, tregoi që buxheti i ndarë është shpenzuar rreth 99%, mirëpo AKP-ja ka pasur edhe përkrahje nga donatorët, e cila është shpenzuar rreth 73.74%. Kërkoj sqarim për mjetet e bartura nga viti 2009, se në cilën kategori ekonomike janë shpenzuar.

Bardha Keqa, prezentoj shkurtimisht pjesën financiare të raportit vjetor të AKP-së, i cili është dorëzuar në Kuvend. Për mjetet e bartura nga viti 2009, sqaroi se ato janë shpenzuar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Nga pjesa e donacioneve financohet pjesa shtesë e pagave për 170 punëtorë lokalë të AKP-së, ndërsa ka pasur edhe dy projekte kapitale të financuara nga Qeveria Amerikane.

Latif Gashi, theksoi se vërejtje të pagave për stafin lokalë jashtë Kosovës në krahasim me atë jashtë Kosovës, pyeti se cila është arsyeja e rritjes së pagave?

Hykmete Bajrami, pyeti se a ka premtime nga donatorët që do ta mbështesin AKP-në tutje në të ardhmen, duke e ditur që buxheti i Kosovës ka mjaft kufizime?

Skott Bowen, sqaroi se në faqen 24 të raportit paraqitet pasqyra e të punësuarve, duke përfshirë këtu stafin jashtë Kosovës i cili paguhet nga donatorët. Sa i përket donatorëve, tregoi që kanë marrë zotime nga Qeveria Britanike dhe Zvicëranë, mirëpo Qeveria e Kosovës duhet ta mbulojë pjesën më të madhe të financimit të AKP-së me të cilat mjete duhet të realizohen shpenzime kapitale.

Latif Gashi, kërkoi informacione më të hollësishme për qasjen në dokumentacionet pronësore, pasi që disa herë ka pasur pengesa nga Agjencioni i Serbisë, a ka qenë kjo qasje në dokumente origjinale apo të fotokopjuara?

Skott Bowen, tregoi që dokumenti origjinal bëhet kopje dhe kur paraqitet nevoja ai dokument vërtetohet me të dhënat kadastrale dhe me dokumentin origjinal.

Kryetarja, konstatoi se komisioni një zëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar të Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2010.

6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për vitin 2010

Miran Zeneli, sqaroi se Këshilli gjatë vitit 2010 ka pasur rritje të kategorisë së mallrave dhe shërbimeve, që sjell si pasojë edhe shkallën më të lartë të shfrytëzimit të buxhetit në krahasim me atë që është paraqitur në raport prej 92%.

Hykmete Bajrami, pyeti lidhur me mos ekzekutimin e vendimeve pasi që në raport është paraqitur si problem?

Hasime Krasniqi, shprehu vërejtje që raporti më tepër është i përmbledhur dhe nuk ka hapësirë për analizë. Edhe pse ky Këshilli ka pasur kërkesë buxhetore shtesë, nuk kanë arritur ta realizojnë as atë buxhet që e kanë pasur në dispozicion.

Miran Zeneli, lidhur me kërkesën buxhetore, sqaroi se ajo ka qenë për rritjen e pagave të anëtarëve të Këshillit, për shkak të ndryshimit të legjislacionit.

Kryetarja, përkrahu vërejtjen e znj. Krasniqi dhe sugjeroi që raportet e ardhshme të vijnë më të detalizuara dhe të paraqitet dinamika e shpenzimit të buxhetit.

Kryetarja, konstatoi se komisioni një zëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë raportin financiar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për vitin 2010.

7. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2010

Kryetarja, njoftoi me kërkesën e përfaqësuesve të Komisionit, që shqyrtimi i raporti të shtyhet në një mbledhje tjetër, pasi gjenden në një udhëtim zyrtar.

Pika shtatë shtyhet për shqyrtim në një mbledhje tjetër të Komisionit.

8. Shqyrtimi i propozimit të Komisionit për përzgjedhjen e anëtarit dhe kryesuesit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Kryetarja, informoi anëtarët e komisionit që Kryesia e Kuvendit e ka autorizuar Komisionin për Buxhet dhe Financa për shqyrtimin e propozimit të komisionit përzgjedhës, mirëpo sipas ligjit kërkohet që Kuvendit t'ia dërgojë Qeverisë këtë propozim, e cila pastaj brenda pesë ditëve duhet ta dërgojë një opinion këta kandidatët e propozuar.

Pas njoftimi, Komisioni njëzëri nxori këtë:

PËRFUNDIM

1. Propozimi i Komisionit për përzgjedhjen e anëtarit dhe kryesuesit të Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, shtyhet për shqyrtim në një mbledhje tjetër të Komisionit, pas kalimit të afatit 15 ditësh, kur Qeveria mund ti dorëzojë Kuvendit një opinion për anëtarët e propozuar.

9. Të ndryshme

9.1 Diskutim për shqyrtimin apo mos shqyrtimin e raporteve financiare tremujore

Anëtarët diskutuan për mundësinë e shqyrtimin apo mos shqyrtimit të raporteve tremujore financiare dhe pas diskutimeve komisioni nxori këtë:

PËRFUNDIM

1. Komisioni do të shqyrtojë sipas procedurës së rregullt vetëm raportet vjetore financiare
2. Me kërkesën e veçantë të komisionit do të shqyrtohet ndonjë raport financiar tremujor.

9.2 Kryetarja njoftoi anëtarët për disa çështje, si në vijim:

- Shpërndarja e CV-ve për anëtarin dhe kryesuesin e propozuar në Bordin e TKPK-së, të cilat kanë ardhur me vonesë në komision.
- Shpërndara e materialit nga Ministria e Financave që sqarojnë dallimet në buxhet, lidhur me raportin e buxhetit për vitin 2010.
- shpërndarja e kërkesës së AKP-së për buxhet shtesë, e cila do të jetë objekt diskutimi në një mbledhje të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

Safete HADËRGJONAJ